



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS DRAGASH

Numri i lëndës: 2022:279812

Datë: 04.06.2024

Numri i dokumentit: 05775162

E.nr. 24/12

GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS DRAGASH, Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil, me gjyqtarin Sabaheta Kurteshi, me pjesëmarrjen e procesmbajtësit Xharije Skenderi, **duke vendosur në lëndën e përmbarimore sipas propozimit të kreditorit Kompania e Sigurimeve “I.” Sh.A të cilën me autorizim e përfaqëson Kompania C., me seli në Prishtinë Rr.. U..., kati..., nr.1/.. Kompleksi te Q. kundër Debitorëve N. Th. etj, nga fshati..., Komuna e Dragashit, për çështjen përmbarimore propozim për Kundërekzekutim - pagesa kryesore**, më datë 03.06.2024 mori këtë:

A K T V E N D I M

I. Propozimi për Kundër ekzekutim - pagesa kryesore i kreditorit Kompania e Sigurimeve “I.” Sh.A të cilën me autorizim e përfaqëson Kompania C., me seli në Prishtinë Rr.. U..., kati..., nr.1/.. Kompleksi te Q. , kundër Debitorëve N. Th. etj , nga fshati..., Komuna e Dragashit, për çështjen përmbarimore propozim për Kundërekzekutim - pagesa kryesore konsiderohet e **TËRHEQUR**.

II. Secila palë i mban shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Kreditorit Kompania e Sigurimeve “I.” Sh.A të cilën me autorizim e përfaqëson Kompania C., me seli në Prishtinë Rr.. U..., kati..., nr.1/.., Kompleksi te Q., kundër Debitorëve N. Th. etj, nga fshati..., Komuna e Dragashit, ka paraqitur në çështjen përmbarimore propozim për Kundërekzekutim - pagesa kryesore në shumë prej 3500,00 euro.

Kjo Gjykatë disa herë ka caktuar seancat e shqyrtimit dëgjimore si dhe seancën dëgjimore me datë 27.06.2023 ku e ka ftuar kreditorin dhe debitorin , të cilin fakte e ka vërtetuar nga flet kthesat postare dhe dorëzuar dhe përmes dorëzuesit të thirrjeve të cilat gjinden në shkresat e lëndës.

Me datë 04.7.2023 gjykata ka pranuar një parashtrësë nga kreditori ku ndër tjera kanë deklaruar se lidhur me thirrjen për seancën e datës 27.06.2023 sipas zyrtarëve në I. dëmi është paguar me përmbarim me datë 20.05.2010 dhe se Kreditori edhe pse të ftuar me rregull, nuk ka kërkuar shtyrjen e seancës dëgjimore (vlen të theksohet se KS I. në këtë procedurë ka qenë në cilësinë

e kreditorit e jo në cilësi të debitorit shih procesverbalin e datës 10.06.2024 ku është precizuar propozimi për kundër ekzekutim).

Prandaj gjykata veprimi konform nenit 42 dhe 17 të Ligjit për Procedurën Përmbartimore si dhe konform nenit 423.3 LPK-së, e me të cilën dispozitë është e paraparë se në qoftë se në seancën kryesore nuk vjen pala kreditore edhe pse është ftuar rregullisht konsiderohet se e ka tërhequr propozimin. Me dispozitën e cekur më lartë është paraparë mungesës së palës në seancën e shqyrtimit dëgjimor në fakte të njëjtit me parashtrësë vetë kanë pranuar të tërhiqet propozimi për kundër ekzekutim). Kështu mungesa e kreditor në seancën e shqyrtimit dëgjimor e tërheq në vete presumcionin e tërheqjes së propozimit. Prandaj për tu konsideruar si i tërhequr propozimi duhet të plotësohen kushtet edhe atë mungesa e kreditorit në procedurë, ftesa ti jetë bërë me rregull. Gjithashtu në këtë rast gjykata ka kuptuar se vetë kreditori sipas parashtrësës së datës 04.07.2023, e ka tërhequr propozimin për kundër ekzekutim .

Përcaktimi i ligjdhënësit për një zgjedhje të tillë duhet kërkuar në faktin se procedura përmbartimore inicohet, me vullnetin ekskluziv të palës kreditore, prandaj vazhdimi i procedurës pa pjesëmarrjen e kreditorit në procedurë nuk do të kishte kurrfarë kuptimi.

Prandaj gjykata duke marrë parasysh të cekurat më lartë ka aplikuar dispozitat e nenit 42 dhe 17 të Ligjit për Procedurën Përmbartimore si dhe konform nenit 423.3 LPK-së,, duke e konsideruar të tërhequr propozimin kreditorit.

Gjykata sa i përket shpenzimeve vendosi që secila palë ti përballoj shpenzimet e krijuara konform nenit 13 të Ligjit të Procedurës Përmbartimore.

Nga se u theksua më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS DRAGASH
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM - DIVIZIONI CIVIL
2022:279812, 04.06.2024**

G j y q t a r i

Sabaheta Kurteshi

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktvendimi mund të ushtrohet ankesë,
Gjykatës së Apelit në Prishtinë në afatin prej 7 ditësh
nga dita e pranimit të aktvendimit, përmes kësaj gjykate.